

Trafiku i udhëtarëve

Neni 63

Në funksion të këtij Kreu termi “udhëtar” do të thotë:

A. në hyrje

1. çdo person që hyn përkohësisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke mos qenë normalisht banues në këtë territor, dhe
2. çdo person që kthehet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin normalisht ai është banues, pasi ka qëndruar përkohësisht në një vend të huaj;

B. në dalje

1. çdo person që largohet përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ku ai është normalisht banues, dhe

40

2. çdo person që pas një qëndrimi të përkohshëm largohet nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ku ai nuk është normalisht banues.

Neni 64

1. Gjatë hyrjes ose daljes nga Republika e Shqipërisë, udhëtari duhet të deklarojë dhe me kërkesë të autoriteteve doganore, duhet të tregojë të gjitha mallrat që transporton.
2. Për të verifikuar deklarimin të cilit i referohet paragrafi 1 i këtij neni, autoritetet doganore, në qoftë se është e nevojshme, mund të kontrollojnë mallrat që transporton udhëtari.
3. Mallrat e transportuara nga korrierët diplomatikë, të shoqëruara me një notë diplomatike, nuk i nënshtrohen kontrollit doganor. Gjithashtu, nuk i nënshtrohen kontrollit doganor deputetët si dhe çdo person tjetër që me ligj i është dhënë status i veçantë, si dhe bagazhet dhe posta që u dërgohet këtyre personave. Kjo dispozitë zbatohet edhe për çdo person tjetër që, sipas dispozitave të tjera në fuqi mund të përfitojë një përjashtim të tillë.